

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Beton Group” shpk. Malishevë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Bazën e Prodhimit të Betonit- Linja 2, Z.K. Bellanicë, Malishevë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 19.08.2024 në ora 10:00 në ShFMU "Naim Frashëri" Fshatin Banjë, Komuna Malishevë, do të organizohet debat publik nga Kompania “Beton Group” shpk. Malishevë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën për Bazën e Prodhimit të Betonit- Linja 2, Z.K. Bellanicë, Malishevë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Beton Group” shpk. Malishevë, Bazën e Prodhimit të Betonit- Linja 2, Z.K. Bellanicë, Malishevë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

“BETON GRUP” SH.P.K.

Rr. Skenderbeu, R 119-Malishevë



RAPORTI

I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR BAZËN E PRODHIMIT TË
BETONIT - LINJA 2 NGA KOMPANIA “BETON GRUP” SH.P.K.,
BELLANICË, MALISHEVË

Qershor, 2024

“BETON GRUP” SH.P.K.

FITIM BEGAJ

Bellanicë, Malishevë

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR
BAZËN E PRODHIMIT TË BETONIT – LINJA 2
Në Parceat me numër 00421-2, 00422-0 dhe 00423-0, Zona kadastrale
Bellanicë, Komuna Malishevë**

Investitori:	“BETON GRUP” SH.P.K.
Pronar:	Fitim Begaj
Adresa:	Rruga Skenderbeu, R 119 – Malishevë
Lokacioni:	Bellanicë, Malishevë
Tel:	+383 49 461 212
Email:	betongrupshpk@gmail.com , fitim.begaj01@gmail.com

Hartuese e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Emri:	Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari
Email:	Blerinabajraktari1@gmail.com Blerinabajraktari3@gmail.com
Tel:	+383 49 588 634
Nr. i Licencës:	07/20

“BETON GRUP” Sh.p.k.

Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari

Nënshkrimi

Nënshkrimi

Përmbajtja:

1.	HYRJE	5
1.1	Përshkrimi i projektit	5
1.2	Vendndodhja e Projektit	7
1.3	Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit	9
1.4	Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit.....	10
1.5	Lënda e pare dhe lënda ndihmëse	11
2.	PËRSHKRIMI DETAL I PROCESIT TEKNOLOGJIK	12
2.1	Deponimi i agregatit	12
2.2	Bunkerët e Agregatit	12
2.3	Përgatitja e agregatit.....	13
2.4	Transportieri i pjerrët i agregatit.....	14
2.5	Mbushja e siloseve	14
2.6	Transporti i çimentos (kërmillori) deri në përzierëse.....	14
2.7	Përcaktimi i sasisë së çimentos	14
2.8	Uji dhe rezervuarët e ujit të deponuar	15
2.9	Rezervarët dhe pompat për aditivët e betonit	15
2.10	Kompresori për ajrin e komprimuar	15
2.11	Prodhimi i gatshëm (Betoni i Freskët).....	15
3.	PËRLLOGARITJA SIPAS LLOJIT DHE SASISË TË MBETJEVE DHE EMETIMEVE TË PRITURA GJATE FAZËS SË OPERIMIT.....	17
4.	KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së.....	19
5.	PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME.....	20
5.1	Zonat me industri te njëjta ekzistuese:.....	20
5.2	Sipërfaqet e fushave te gjelbërta:.....	20
5.3	Afërsia me lëndët e para:.....	20
5.4	Infrastruktura e transportit:.....	20
5.5	Ndikim mjedisor:	20
5.6	Zonimi dhe rregulloret:.....	20
5.7	Marrëdhëniet me komunitetin:	21
5.8	Shërbimet komunale dhe infrastruktura:	21
5.9	Kushtet gjeologjike dhe gjeoteknike:.....	21
5.10	Kërkesa e tregut:.....	21
5.11	Mbrojtje dhe siguri:	21
5.12	Potenciali i zgjerimit:	21

5.13 Logjistika dhe vendi i lokacionit:.....	21
5.14 Qëndrueshmëria mjedisore:.....	21
5.15 Afërsia me fuqinë punëtore:.....	21
6. GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT	22
6.1 Flora dhe Fauna	23
6.2 Klima dhe Temperatura.....	24
6.3 Karakteristikat Hidrografike	24
6.4 Lagështia relative e ajrit.....	25
6.5 Vrantësimi dhe diellosja.....	25
6.6 Të reshurat	25
6.7 Era	25
7. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS	26
7.1 Ndikimet në ajër	26
7.2 Ndikimet në tokë	27
7.3 Ndikimet në ujë	28
7.4 Ndikimet në peizazh	29
7.5 Ndikimet në Florë dhe faunë	30
7.6 Ndikimet në vendbanime dhe popullatë	30
7.7 Ndikimet nga zhurma	31
7.8 Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore	32
7.9 Erozioni	32
7.10 Pasuritë nëntokësore	32
8. PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS	33
9. PËRSHKRIMI I METODAVE PER VLERSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE	34
10. PËRSHKRIMI I MASAVE	36
10.1 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër.....	36
10.2 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë dhe në tokë	37
10.3 Masat për mbrojtje nga zhurma	40
10.4 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë	40
10.5 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë.....	41
10.6 Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore	41
10.7 Menaxhimi i mbeturinave.....	41
11. PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE	42
12. MONITORIMI DHE RAPORTIMI.....	42
13. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHËSHME.....	42

14. ANALIZA KOST – BENEFITE E PROJEKTIT NË FORMË TABELARE	44
15. LITERATURA E PERDORUR	45

Lista e Figurave:

Figura 1 Planifikimi i vendosjes se bazës se betonit nga kompania BETON GRUP SH.P.K.....	6
Figura 2 Shtirirja hapësinore e Lokacionit të Bazës për prodhimin e Betonit "BETON GRUP" Sh.p.k.....	8
Figura 3 Lokacioni i bazës për prodhimin e betonit“Beton Grup” Sh.p.k. nga Komuna e Malishevës....	8
Figura 4 Lokacioni i planifikuar për ngritjen e bazës se betonit me objektet për rreth	9
Figura 5.Deponimi i Agregatit	12
Figura 6.Bunkeret e Agregatit	13
Figura 7 Procesi teknologjik i Punës së bazës për prodhimin e betonit.....	16
Figura 8 Rrjeti Hidrografik i komunës se Malishevës	25
Figura 9 Largësia e Bazës se betonit me bizneset tjera për rreth saj.....	31
Figura 10 Skema e trajtimit te ujerave te ndotura	38
Figura 11 Sedimentuesi i ndertuar nga kompania për trajtimin e ujerave nga baza për prodhimin e betonit.....	39
Figura 12 Ortofoto e lokacionit te bazes se prodhimit te betonit e rrethuar me llamarine dhe mure betoni	40

Lista e Tabelave:

Tabela 1 Tabela e vlerave te lejuara te zhurmës	31
-------------------------------------------------------	----

1. HYRJJE

Bazuar në nenin 11 dhe shtojcën 4 të Ligjit me nr. 08/L-181 për vlerësimin e ndikimit në mjedis, si dhe duke u bazuar në përmbushjen e kushteve ndërtimore, kompania “BETON GRUP” SH.P.K. nga Malisheva ka filluar përgatitjen e dhe kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e prodhimit të betonit

“BETON GRUP” Sh.p.k. është kompani e themeluar në muajin Dhjetor të vitit 2014 për prodhimin e betonit, e cila ka planifikuar ndërtimin e impiantit për prodhimin e betonit në parcelat me nr. 00421-2, 00422-0 dhe 00423-0, ZK. Bellanicë në Komunën e Malishevës.

Ky raport paraqet një dokument të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për marrjen e Pëlqimit Mjedisor për shkak të rritjes së kapacitetit, me qëllim që të identifikohen dhe analizohen ndikimet në mjedis nga ndërtimi i impiantit për prodhimin e betonit dhe të tërë veprimtarisë së bazës për prodhimin e betonit duke i parashtruar dhe ndërmarr masat e domosdoshme për mbrojtjen e mjedisit në lokacionin ku do të ushtrohet kjo veprimtari. Në raportin e VNM-s do të analizohen karakteristikat e gjendjes ekzistuese të mjedisit në lokalitetin e planifikuar për ndërtimin e bazës së betonit si dhe karakteristikat e potencialeve përkatëse, nga njëra anë, dhe karakteristikat inxhinieriko - teknike të punëve të cilat zhvillohen në bazë të projektit, nga ana tjetër, shtrohet nevoja për hartimin e Raportit të VNM-së ku do të përkufizohen të gjitha ndikimet relevante që mund të paraqiten në relacionin bazë e betonit për prodhimin e betonit dhe mjedis, duke mos anashkaluar edhe ndikimet kumulative në regjionin më të gjerë. Duke u nisur nga qëllimi paraprak dhe në metodologjinë e hartimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ky Raport bëhet me qëllim të përkufizimit të ndikimeve potenciale dhe caktimin e masave të cilat do të jenë të nevojshme për tu marr për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative. Me hartimin e Raportit të VNM -së janë marrë për bazë ndikimet në mjedis dhe aplikimi i masave për zvogëlimin e ndikimeve gjatë realizimit të ngritjes së bazës për prodhimin e betonit si dhe pas përfundimit të projektit.

Ndërtimi i bazës për prodhimin nga kompania “BETON GRUP” Sh.p.k. është planifikuar të behet në parcelat me nr. 00421-2, 00422-2 dhe 00423-0 të cilat kanë sipërfaqe prej $(1254 + 1918 + 1275) \text{ m}^2 = 4447.00 \text{ m}^2$ apo 44 Ari e 47 m^2 .

1.1 Përshkrimi i projektit

Ky projekt do të përfshijë detajimin e komponentëve, proceseve dhe pajisjeve kryesore të përdorura për prodhimin e betonit në një mënyrë sistematike dhe efikase. Qëllimi i ndërtimit të bazës për prodhimin e betonit ka qenë për nevojën ndërtimore lokale, furnizim komercial

dhe kërkesave tjera specifike. Është planifikuar si fillim te ketë një kapacitet maksimal deri 50 m³/orë prodhim betoni të freskët.

Vendndodhja e lokacionit te planifikuar të bazës se betonit është përzgjedhur sepse prona është private e kompanisë, rrugët lokale dhe autostrada Prishtinë – Prizren, janë shume afër, ne afërsi te bazes se prodhimit te betonit Linja 2, ka shume biznese tjera te cilat veprojnë ne afërsi te lokacionit të planifikuar ku eshte vendosur baza per prodhimin e betonit. Përparësi e këtij lokacioni është se ka energji elektrike te qëndrueshme e cila është njëra nder komponentët kryesore si gjate ndërtimit e po ashtu edhe gjate funksionalizimit të bazës për prodhimin e betonit si dhe ka sasi te mjaftueshme te ujerave nëntokësorë dhe sipërfaqësorë te cilat jane lendet kryesore që përdoren tek prodhimi i betonit dhe mirëmbajtja e ambientit, ndërsa lendet tjera te para si Zhavorri ne fraksione, rëra, çimento dhe aditivët (nëse përdorën) këto përpunohen dhe deponohen tek baza e betonit.



Figura 1 Planifikimi i vendosjes se bazës se betonit nga kompania BETON GRUP SH.P.K

Baza e prodhimit te betonit do te përbëhet nga:

- 2 Siloet e çimentos,
- 4 Bunkerët e fraksioneve te zhavorrit,
- Shiritit te lëvizjes për sjelljen e zhavorrit,
- Mikseri për përzierjen e lëndëve te para,
- Kulla e kontrollit

Pas prodhimit te betonit ne mikserin e përzierjes se lendeve te para e cila kontrollohet nga stafi i specializuar për këtë lëmi, behet ruajtja e betonit te sapo përzier siç janë kamionët special transportues, ku para se te shkarkohet ne këta kamion behet testimi i betonit te freskës se a është sipas klasës se kërkuar.

Orari i punës është ne kete baze betoni eshte nga ora 08:00 – 16:00 sipas nevojës mund te kërkohej qe te vazhdohej edhe me shume për arsye te mos ndërprerjes se prodhimit te betonit. Ne fund te çdo orari te punës behet pastrimi i makinerive dhe përgatiten për ditën e ardhshme për pune me te mire.

Kosto e bazës se prodhimit të betonit Linja 2 është 80,000.00 €, Sepse kompania e ka dislokuar bazën per prodhimin e betonit nga një lokacion tjetër te cilën e ka sjelle ne lokacion te ri per te cilin po kerkohet Pelqimi Mjedisor.

Duke u bazuar në kërkesat të cilat dalin Ligji i ndërtimit, ku njera nder kushtet është edhe Hartimi i Raportit të vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për tu pajisur me Pëlqim Mjedisor, kompania “Beton Grup” SH.P.K., ka angazhuar persona fizik të licencuar për Hartimin dhe përgatitjen e Raportit të Vlerësimit të ndikimit në Mjedis për Bazën e Prodimit te betonit me lokacion në Gllaviçicë, përkatësisht ne parcelat me nr. 00421-2, 00422-0 dhe 00423-0, ZK. Bellanicë në Komunën e Malishevës.

Ky raport është hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Shtojca 4. Po ashtu qëllimi kryesor i këtij raporti të VNM-së është identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedis me qëllim të ndërmarrjes së masave të nevojshme për ti minimizuar ndikimet negative në Mjedis gjate ndërtimit e po ashtu edhe gjate operimit.

1.2 Vendndodhja e Projektit

Objekti i Bazës së prodhimit te betonit me të gjitha objektet përcjellëse është vendosur në ngastrat kadastrale me nr. 00421-2, 00422-0 dhe 00423-0, ZK. Bellanicë në Komunën e Malishevës, e cila gjendet ngjitur me rrugen e cila e lidhe qytetin e Malisheves me Autostradën Ibrahim Rugova ne afersi te kycjes kryesore në fshatin Bellanicë.




Figura 2 Shtirja hapësinore e Lokacionit të Bazës për prodhimin e Betonit "BETON GRUP" Sh.p.k.




Figura 3 Lokacioni i bazës për prodhimin e betonit "Beton Grup" Sh.p.k. nga Komuna e Malishevës

Ne afërsi të lokacionit ku është ndertuar baza për prodhimin e betonit Linja 2 nga kompania "BETON GRUP" SH.P.K. nuk ka shtëpi afër, shtëpitë me të afërta janë në distance 89 metra, ndërsa në afërsi të parcelës gjenden disa biznese tjera me veprimtari të ndryshme.

Kompania “Beton Grup” SH.P.K. edhe pse para se te ndertoj linjen e dyte te prodhimit te betonit ne ato parcela ka pasur te ndertuar bazen e pare te prodhimit te betonit dhe asnje here nuk ka patur ndonje problem me banoret lokal.



Figura 4 Lokacioni i planifikuar për ngritjen e bazës së betonit me objektet për rreth

1.3 Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit

Baza për prodhimin e betonit përbehet si ne vijim:

1. Bunkerët e agregatit $3 \times 20 = 60$ [m³] së bashku me pistonat dhe pajisjet përcjellëse,
2. Transportieri horizontal mbledhës – Dozatori,
3. Transportieri i pjerrët furnizues i agregatit,
4. Përziersja e betonit - Mikserët me fuqi $P = 2 \times 30 = 60$ [kW],
5. Peshorja digjitalë e çimentos,
6. Siloset e çimentos ($2 \times 50 = 100$ [t]),
7. Transportieri kërmillor i çimentos $\varnothing 273$ [mm], $L = 5000$ [mm],
8. Transportieri kërmillor i çimentos $\varnothing 273$ [mm], $L = 5000$ [mm],
9. Rezervuari i ujit me pajisje përcjellëse (30 [m³]),

10. Rezervuaret e aditivit dhe paisjeve përcjellëse,
11. Kompresori i ajrit të komprimuar ($P = 7.5 \text{ [kW]}$),
12. Gjeneratori me naftë $P = 125 \text{ [kVA]}$.
13. Kabina komanduese e Bazës së Betonit,

Kapaciteti prodhues i Fabrikës për Prodhimin e Betonit është $Q \sim 50 \text{ [m}^3/\text{h]}$ me prodhues Italian të markës SIMEN.

1.4 Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit

Faza operative e një baze prodhimi betoni përfshin aktivitetet dhe proceset e përditshme të nevojshme për të prodhuar beton në mënyrë efikase dhe efektive.

Me poshtë do të paraqesim karakteristikat kryesore të kësaj faze:

Përbërja dhe Përzierja: Prodhimi i betonit fillon me grumbullimin e saktë të lëndëve të para, duke përfshirë çimento, agregate (të tilla si rëra dhe zhavorri), uji dhe nganjëherë aditivët si përzierjet. Dizajni i përzierjes së betonit është thelbësor, dhe përbërësit duhet të maten me saktësi dhe të përzihen në përmasat e duhura për të arritur vetitë e dëshiruara të betonit.

Funksionimi i pajisjes: Baza e prodhimit të betonit zakonisht përfshin funksionimin e pajisjeve të ndryshme, duke përfshirë impiantet e grumbullimit të betonit, miksera, transportues dhe kamionë. Këto makina duhet të mirëmbahen dhe operohen siç duhet për të siguruar prodhim të qëndrueshëm dhe me cilësi të lartë të betonit.

Kontrolli i cilësisë: Kontrolli i cilësisë është një aspekt kritik i fazës operacionale. Testimi dhe monitorimi i rregullt i vetive të betonit, të tilla si rrëshqitja, qëndrueshmëria në shtypje dhe punueshmëria, janë thelbësore për të siguruar që betoni përmbush specifikimet e projektimit dhe standardet e industrisë.

Masat e sigurisë: Sigurimi i sigurisë së punëtorëve është një prioritet kryesor gjatë fazës operacionale. Kjo përfshin sigurimin e pajisjeve të përshtatshme mbrojtëse personale, zbatimin e protokolleve të sigurisë dhe kryerjen e trajnimeve të rregullta të sigurisë.

Pajtueshmëria mjedisore: Pajtueshmëria me rregulloret mjedisore është jetike. Kjo përfshin menaxhimin e mbetjeve dhe rrjedhjeve, parandalimin e ndotjes dhe minimizimin e ndikimit mjedisor të procesit të prodhimit të betonit, ku duhet patur kujdes në ruajtjen e tokës së shfrytëzuar ku është vendosur baza e betonit, ruajtjen e ujit nga ndotja dhe biodiversitetin.

Menaxhimi i inventarit: Menaxhimi efektiv i inventarit është thelbësor për sigurimin e një furnizimi të vazhdueshëm të lëndëve të para dhe ruajtjen e efikasitetit të prodhimit. Kjo përfshin monitorimin e niveleve të çimentos, agregateve dhe furnizimeve të tjera për të shmangur mungesat ose mbingarkesat.

Efikasiteti i Energjisë: Përdorimi efikas i energjisë është thelbësor për kursimin e kostos dhe qëndrueshmërinë mjedisore. Pajisjet dhe praktikat me efikasitet energjetik mund të reduktojnë kostot operacionale dhe të minimizojnë gjurmën e karbonit të prodhimit të betonit.

Mirëmbajtja dhe riparimet: Mirëmbajtja dhe riparimi i rregullt i pajisjeve janë thelbësore për të parandaluar prishjet dhe për të ruajtur vazhdimësinë e prodhimit. Duhet të kryhet mirëmbajtja e planifikuar për të mbajtur pajisjet në gjendje të mirë pune.

Dorëzimi i betonit: Koordinimi i dorëzimit në kohë të betonit në kantieret e ndërtimit është një pjesë kyçe e fazës operacionale. Kjo mund të përfshijë përdorimin e kamionëve të betonit, pompave ose metodave të tjera të transportit.

Mbajtja e të dhënave: Mbajtja e të dhënave të sakta të prodhimit të betonit, testeve të kontrollit të cilësisë, mirëmbajtjes së pajisjeve dhe procedurave të sigurisë është thelbësore për gjurmimin e performancës, sigurimin e llogaridhënies dhe përmbushjen e kërkesave rregullatore.

Përmirësimi i Vazhdueshëm: Faza operacionale duhet të përfshijë një kulturë të përmirësimit të vazhdueshëm. Rishikimi dhe optimizimi i rregullt i proceseve, pajisjeve dhe masave të sigurisë mund të çojë në rritjen e efikasitetit dhe kursimeve të kostos.

Pajtueshmëria me standardet: Respektimi i standardeve të industrisë dhe kodeve lokale të ndërtimit është thelbësor për të siguruar që betoni i prodhuar të plotësojë specifikimet e kërkuara për projekte të ndryshme ndërtimi.

Faza operative e një baze prodhimi betoni është një proces kompleks dhe dinamik që kërkon planifikim, monitorim dhe menaxhim të kujdesshëm për të prodhuar beton me cilësi të lartë në mënyrë efektive duke përmbushur standardet e sigurisë dhe mjedisit.

1.5 Lënda e pare dhe lënda ndihmëse

Lendet e para te prodhimit te betonit janë:

- Çimento,
- Agregati,
- Uji dhe
- Aditiviet here pas here

Lendet kryesore për funksionimin e bazës se betonit:

- Energjia elektrike,

2. PËRSHKRIMI DETAL I PROCESIT TEKNOLOGJIK

Kapaciteti maksimal për prodhimin e betonit të freskët është ~ 50 [m³/h] dhe fillon me përgatitjen e materialeve si rëra dhe zhavori, çimento, uji dhe aditivet (nëse është i nevojshëm përdorimi i tyre). Prodhimi i betonit në betonuare fillon me përgatitjen e lëndëve të para: agregatit (fraksioneve të gurit apo fraksioneve të rërës), çimentos dhe ujit.

Procesi teknologjik i prodhimit të betonit të freskët ka këtë rrjedhë:

2.1 Deponimi i agregatit

Agregati i granulave të ndryshme sillet me kamionë ose me lugë ngarkuese deri në hapësirën për deponim të agregatit në Fabrikën e Betonit



Figura 5. Deponimi i Agregatit

2.2 Bunkerët e Agregatit

Procesi teknologjik për prodhimin e betonit, fillon me mbushjen e siloseve me rërë apo gur me granulacione të ndryshme në varësi të markës së betonit që dëshirohet të prodhohet, siloset pranues me fraksione të gurit ose rërës mbushen me anë të lugës ngarkuese nga depoja e fraksioneve të agregatit, katër siloset me fraksione të gurit ose rërës, janë të ndara njëra prej tjetrës me mure të pllakave të çelikut, $3 \times 20 = 60$ [m³].



Figura 6. Bunkeret e Agregatit

2.3 Përgatitja e agregatit

Nga bunkerët e agregatit me vëllim $V = 3 \times 20 = 60$ [m³] në dozatorin bëhet zbrazja e agregatit përmes mbyllëseve që komandohen përmes pistonave pneumatik. Nga bunkerët e agregatit, agregati përmes transportierit horizontal mbledhës – Dozatorit bartet në Transportierin e Pjerrët Furnizues të Agregatit ku me pas agregatin e gatshëm e dorëzon në përzierësen e Betonit – Mikserit.

Hapja e fortinave të dozatorëve të caktuar, është e programuar në varësi nga granulati i agregatit që kërkohet për tipin dhe markën e betonit. Për çdo tip apo markë betoni procesi teknologjik është i programuar dhe menaxhohet nga kabina komandues. Projekti i këtij sistemi, me lëshuarje në punë të tërë linjës teknologjike mundëson plotësisht **menaxhimin automatik** të tërë procesit teknologjik të prodhimit të betonit.

Përbërësit tjerë të konglomeratit për beton si çimento që vije nga siloset e çimentos nëpërmjet transportierëve kërmillor hidhët në dozatorin e çimentos dhe po i njëjti, në masën e caktuar sipas parametrave bie në mikser volumi i të cilit është **1.5** [m³].

Agregati nga të katër bunkerët në dalje të cilëve ndodhën dozuesit elektro - pneumatik të cilët me dhënien e komandës nga tabela komanduese hapen dhe mbyllen në mënyrë automatike pasi ta lëshojnë sasinë e caktuar të agregatit në shiritin transportues që ndodhet në siloset e agregatit i cili i transporton granulacionet (fraksionet) e agregatit gjer në transportierin e pjerrët furnizues të agregatit - enën e cila nevojitet për bartjen e fraksioneve të agregatit gjer në mikser (përzierëse) për prodhimin e betonit. Në dozuesit e fraksioneve më të imta janë të vendosur vibruesit me qëllim të rrjedhjes së fraksioneve sa më lehtë në enën e agregatit.

2.4 Transportieri i pjerrët i agregatit

Nëpërmjet transportierit horizontal furnizues – Dozatorit respektivisht transportierit të pjerrët të agregatit, agregati i përgatitur transportohet dhe hidhet në përzierësen e betonit – Mikser.

2.5 Mbushja e siloseve

Mbushja e silosit (rezervuarit) të çimentos bëhet me auto-cisternë me ndihmën e pajisjeve pneumatike.

Mbi siloset, janë të vendosur Euro-filtrat si dhe tubat pneumatik të cilët veprojnë tek siloset. Euro-filtrat janë të prodhimit italian dhe shërbejnë për pastrimin e ajrit nga pluhuri që del nga siloset gjatë mbushjes së tyre nga auto-cisterna dhe punës kontinuale të tyre për furnizimin e përzierëses me çimento.

Të ngarkuarit e silosit (Poz. 05), gjegjësisht deponimi i çimentos bëhet me hapjen e valvualve përkatëse (V1, V2) dhe përmes tubave (T1, T2), me shtytje pneumatike (Sh1, Sh2) dhe hedhet në brendi të silosit. Funkzioni i mbushjes dhe zbrazjes së silosit është i kontrolluar përmes niveluesit (N1, N2) me sinjalizim si dhe sistem alarmi

2.6 Transporti i çimentos (kërmillori) deri në përzierëse

Transporti i çimentos nga silosat e deri në përzierësen e betonit - mikser behët përmes dy kërmilloreve me gjatësi $L = 7000$ [mm].

Dozimi i çimentos në përzierës bëhet nëpërmes transportuesit kërmillor nga silosi. Çimentoja me ramje të lirë bien në transportuesin të vendosur nën silos, pasandaj nëpërmjet transportuesit kërmillor dozohet në enën e peshojës për çimento. Zbrazja e enës së peshojës kryhet në mënyrë të programuar dhe atë në kohën e dozimit të agregatit në mikser (përzierëse). Ashtu që zbrazja e pajisjes për dozim të çimentos në mikser (përzierës) fillon automatikisht në momentin e fillimit të dozimit të agregatit nga ena në mikser (përzierës), apo disa sekonda më vonë.

Gjatë kohës së zbrazjes së enës së peshojës me çimento duhet të lëshohet vibruesi, kur procesi kryhet në mënyrë manuele, kur procesi kryhet në mënyrë automatike vibruesi lëshohet në mënyrë automatike.

2.7 Përcaktimi i sasisë së çimentos

Përcaktimi i sasisë së çimentos bëhet me anën e peshores matëse në vartësi nga lloji i recepturës së betonit të freskët.

2.8 Uji dhe rezervuarët e ujit të deponuar

Uji për furnizim të përzierëses - mikserit sigurohet nga pusi nëntokësor - bunari të hapura në këtë Bazë të Betonit dhe me pas uji akumulohet në rezervuarët e ujit 10 000 [litra] respektivisht në peshoren automatike.

Dozimi i ujit në përzierës si lëndë e parë bazë për përfitimin e betonit bëhet me dozimin e programuar nga pompa për furnizim me ujë kryhet gjithashtu në mënyrë automatike me fillimin e dozimit të çimentos. Pas dozimit të sasisë së caktuar të ujit, ventili dozues automatikisht mbyllet.

Nëse janë përmbushë kushtet e procesit për punë automatike (sasia e nevojshme e agregatit në fortin, shtypja e ujit duhet të jetë min. 3 [at] dhe sasia e nevojshme e çimentos), sasia e prodhuar e betonit për një cikël është 1.0 [m³], zgjatja e një cikli është përafërsisht 60 [s] në varshmëri të llojit të betonit.

Gjatë kryerjes së procesit në mënyrë manuele koha e zgjatjes së ciklit varët nga aftësia e punëtorit që operon me pajimet për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit

2.9 Rezervarët dhe pompat për aditivët e betonit

Që të zhvillohet procesi i përfitimit të betonit si komponentë lidhëse mbetet ardhja apo dozimi i ujit dhe komponentëve tjera si aditivët të cilat shtohen në varësi nga tipi i betonit dhe kushteve tjera që kërkohen në implementimin e betonit.

Sasia e ujit bëhet po ashtu me dozim nga dozatori dhe pompa për furnizim me ujë.

2.10 Kompresori për ajrin e komprimuar

Procesi i mbylljes së dozatorëve të agregatit, dhe pajisjeve tjera përcjellëse në Fabrikën e Betonit, realizohet përmes pistonave pneumatike që furnizohen me ajër të komprimuar nga kompresori pistonik.

2.11 Prodhimi i gatshëm (Betoni i Freskët)

Prodhimi i gatshëm (betoni i freskët) nëpërmjet hinkës zbrazet nga fundi i përzierëses në auto-përzierëset dhe me pas bartet te klienti.

Që të zhvillohet procesi i përfitimit të betonit si komponentë lidhëse mbetet ardhja apo dozimi i ujit dhe komponentëve tjera si aditivët të cilat shtohen në varësi nga tipi i betonit dhe kushteve tjera që kërkohen në implementimin e betonit. Sasia e ujit bëhet po ashtu me dozim nga dozatori dhe pompa për furnizim me ujë.




Figura 7 Procesi teknologjik i Punës së bazës për prodhimin e betonit

3. PËRLLOGARITJA SIPAS LLOJIT DHE SASISË TË MBETJEVE DHE EMETIMEVE TË PRITURA GJATE FAZËS SË OPERIMIT

Pasi qe betonjera eshte e ndertuar tashme, me poshte do ti pershkruajme te gjitha emetimet e pritura gjate fazës se operimit, :

- **Uji:** Kualiteti i ujerave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga aktiviteti i punës së bazës së Betonit nuk do te ndikoj negativisht, por duke u bazuar ne masat e marrura nga kompania, nuk do te ndikoj negativisht gjate fazës se operimit, ndotja është minimale. Shfrytëzimi i ujit do të përdoret për proces teknologjik të prodhimit të betonit si lende e pare por njëkohësisht do te përdoret edhe për pastrimin e makinerive, nevojat sanitare e higjienike te administratës si dhe ujitjen e sipërfaqeve manipuluese gjate kohërave te thata dhe shume te nxehta për ndalimin e ngritjes se pluhurave ne ajër. Shfrytëzimi i ujit i cili përdoret për nevoja teknologjike nuk shkarkohet sepse është njëra nga lendet e para te prodhimit ndërsa nga pastrimi i makinerive do te shkarkohet ne sedimentuesin për trajtimin e ujerave dhe pas trajtimit do te përdoret për pastrim te rrugëve ndërsa ujerat e shkarkuara nga punëtorët do te shkarkohen ne rrjetin e kanalizimit te fshatit. Ndikimi kryesor i ndotjes se ujerave janë shkarkimet e ujerave te pa trajtuara ne mungesë të impianteve por ne rastin ne fjale projektuesi ka parapare trajtimin e ujerave te ndotura nga e gjithë kompania.
- **Ajri:** Nga ky aktivitet kemi ndotje ne kufij te lejuar nga pluhuri gjate mbushjes se bunkerëve, nga lëvizja e makinerive ne sipërfaqet manipuluese si dhe ne raste te përdorimit te makinerive te vjetra mund te ndodhe qe lirimi i gazrave te ndikoj ne ajër. Ndikime minimale ne ajër, ndodhin, gjate sjelljes se materialeve ndërtimore me kamion si dhe gjate lëvizjes së mikserëve por janë ndikime te cilat mund te kontrollohen lehte.
- **Dheu** – duke konsideruar kapacitetet e projektuara të bazës së betonit, kanalet si dhe si rezultat i investimit adekuat ne makineri te reja nuk do te kemi ndikime te mëdha ne dhe ndërsa ujerat sipërfaqësore largohen ne mënyrë te kontrolluar dhe se nuk shkarkohen ne ujera nëntokësore, ku një pjese e tyre largohen ne mënyrë natyrore ndërsa një pjese tjetër do te trajtohet ne sedimentues dhe përsëri do te merret për shfrytëzim dhe mund të konstatohet se ndikimet në kualitetin e dheut dhe nën të janë minimale.
- **Zhurma** – gjate operimit mund te ketë zhurmë gjate lëvizjes se makinerive e cila është e pranueshme sipas normave, po ashtu edhe gjate operimit është minimale.

-
- **Dridhjet** – Territori i komunës së Malishevës i takon Zonës së V-të (pesë) të presionit (goditjes sizmike), 7-8 gradë në bazë të "MSC". Nuk ka të dhëna për mikro-zonat sizmike.
 - **Drita, nxehtësia dhe rrezatimi** – Janë tri dukuri që të tri-at se bashku të ndihmojnë në realizimin e punës ku është ndërtuar baza për prodhimin e betonit e cila ka dritë, rrezatim diellor dhe nxehtësi të mire, por në temperatura shumë të larta rekomandohet që të ndërkehet puna për arsye të ngurtësimit të shpejtë të betonit i cili mund të hupe vetitë e tij. Në bazë të vërejtjeve të diellosjes në katër stacionet metrologjike (Prishtinë, Ferizaj, Prizren, Pejë), ka dalë se Kosova ka mesatarisht 2066 orë me diell gjatë vitit ose mesatarisht 5,7 orë në ditë. Vlera më e lartë e diellosjes e regjistruar në Prishtinë është 2140 orë /vit(h/v) dhe më e ulëta në Pejë: 1958 orë /vit (h/v). Gjatë vitit në muajin korrik ka më së shumti diellosje, kurse në dhjetor më së paku.
 - **Flora dhe Fauna** – Ky aktivitet në aspektin e ndikimeve fizike në florë dhe faunë është minimal. Nuk parashihen ndikime të theksuara në florë dhe faunë për arsye se në atë zonë nuk ka zhvillim të florës dhe faunës, ndërsa sa i përket pjesëve malore gjendja e florës dhe faunës nuk është e kënaqshme, shkaktarë të kësaj gjendje janë: gjuetia e paligjshme dhe pa kriter, përndjekja dhe kapja e kafshëve me qëllim tregtie, shqetësimi i vazhdueshëm nga ana e njeriut, peshkimi i paligjshëm, prerja, djegia dhe dëmtimi i pyjeve, shkatërrimi i habitateve natyrore, ndikimi i urbanizmit, transportit dhe turizmit, grumbullimi pa kriter i bimëve mjekuese dhe kërpudhave etj.
 - **Ndikimet sociale dhe ekonomike** – Mund të thuhet se ky aktivitet nuk do të paraqes ndonjë ndikim negativ në komunitetin lokal. Përkundrazi, priten efekte pozitive, ku baza e betonit ka gjithsej e ketë 5 punëtorë në prodhim 3 punëtorë në administratë të cilët do të përfitojnë paga dhe mëditje të mira. Ky Projekt pritet të ndikoj pozitivisht në ekonominë Vendore dhe lokale të Komunës së Malishevës.

4. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së

Bazuar në karakteristikat e bazës së prodhimit të betonit me te gjithë infrastrukturën përcjellëse dhe sipas gjendjes ekzistuese (vendndodhja, madhësia e shtrirjes, ndikimet e mundshme në mjedis etj.), ky projekt është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis. **Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis** i cili është baza kryesore ligjore te cilit ju kemi referuar. Shtojca 2 e këtij ligji, nenparagrafi 5.8:

Për përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar edhe ligje te tjera relevante, si:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 05/L-025
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për Mbrojtje nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për Ndërtim Nr. 04/L-110.

Udhëzimet Administrative:

- Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve ne ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes;
- Udhëzim Administriv (MMPHI) Nr. 02/2022 per kushtet , menytrat ,parametrat dhe vlerat kufizuese te shkarkimit te ujerave te ndotura ne rrjetin e kanalizimit public dhe trupin uJOR.

Pasi që për këtë veprimtari është e nevojshme të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM), atëherë për të adresuar ndikimet mjedisore të mundshme, masat për zvogëlimin e ndikimeve dhe përputhshmërinë ligjore, investitori ka vendosur që të kryej një studim përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të përgatis raportin dhe të aplikon për pëlqim mjedisor në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).

5. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME

Gjatë zgjedhjes së një vendi për ndërtimin e një baze prodhimi betoni, është thelbësore të merren parasysh alternativa të ndryshme të arsyeshme për të siguruar zgjedhjen e vendndodhjes optimale.

Më poshtë do të japim një përshkrim të disa prej alternativave të arsyeshme që duhen marrë parasysh gjatë procesit të përzgjedhjes së lokacionit:

5.1 Zonat me industri te njëjta ekzistuese:

Përdorimi i një zone me industri ekzistuese te njëjta mund të jetë një alternativë me kosto efektive. Zona të tilla mund të kenë tashmë infrastrukturë, shërbime komunale dhe lidhje transporti, duke reduktuar kostot fillestare të konfigurimit. Ne komunën e Malishevës janë planifikuar disa zona industriale/ekonomike me planin zhvillimor komunal disa janë parapare përgjatë rrugës regjionale, lokacioni ku është planifikuar ndërtimi i bazës së prodhimit të betonit i përket një zone me industri te ndryshme.

5.2 Sipërfaqet e fushave te gjelbërta:

Vendet e fushave te gjelbërta janë tokë të pazhvilluar. Ndërsa mund të kërkojnë më shumë investime fillestare në infrastrukturë, ato ofrojnë një fushe të zbrazët për projektimin e një objekti prodhimi betoni sipas specifikave tuaja të sakta.

5.3 Afërsia me lëndët e para:

Përzgjedhja e një vendi afër burimeve të lëndëve të para thelbësore, të tilla si agregatet dhe çimentoja, mund të zvogëlojë kostot e transportit dhe të rrisë efikasitetin operacional.

5.4 Infrastruktura e transportit:

Afërsia me rrugët kryesore është thelbësore për shpërndarjen efikase të produkteve të betonit. Është konsideruar se lokacioni i bazës së prodhimit të betonit ka akses të mirë në rrugët kryesore, lokale dhe ne autostrade.

5.5 Ndikim mjedisor:

Vlerësimi i ndikimit mjedisor të secilit vend, duke marrë parasysh faktorë si cilësia e ajrit dhe ujit, ruajtja e habitatit dhe kërkesat e mundshme të rehabilitimit.

5.6 Zonimi dhe rregulloret:

Hetoni rregulloret lokale të zonimit dhe kërkesat e lejeve për çdo vend të mundshëm. Sigurohuni që operacionet tuaja do të jenë në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse.

5.7 Marrëdhëniet me komunitetin:

Vlerësimi i pranueshmërinë se komunitetit ndaj një objekti për prodhim betoni. Marrëdhëniet e mira me komunitetin janë thelbësore për të shmangur konfliktet dhe për të siguruar një proces më të qetë të lejeve.

5.8 Shërbimet komunale dhe infrastruktura:

Kontrolloni disponueshmërinë dhe kapacitetin e shërbimeve, duke përfshirë ujin, energjinë elektrike dhe sistemet e ujërave të zeza, në çdo vend. Përmirësimi ose instalimi i shërbimeve mund të jetë i shtrenjtë.

5.9 Kushtet gjeologjike dhe gjeoteknike:

Kryerja e studimeve të tokës dhe gjeoteknike për të siguruar që vendi i zgjedhur mund të mbështesë makineritë dhe strukturat e rënda të nevojshme për prodhimin e betonit.

5.10 Kërkesa e tregut:

Analizoni kërkesën për beton në rajon. Një faqe që është më afër tregut tuaj të synuar mund të zvogëlojë kostot e transportit dhe të rrisë konkurrencën.

5.11 Mbrojtje dhe siguri:

Është marr parasysh siguria e zonës për sa i përket rreziqeve të fatkeqësive natyrore, shkallës së krimit dhe shqetësimeve të tjera të sigurisë. Kjo është thelbësore për sigurinë e personelit dhe pajisjeve.

5.12 Potenciali i zgjerimit:

Është bere vlerësimi, nëse vendi i zgjedhur lejon zgjerimin e ardhshëm, nëse biznesi i prodhimit të betonit rritet. Kostoja e tokës dhe e ndërtimit: Llogaritja e kostos se blerjes së tokës dhe ndërtimit në çdo vend, duke marrë parasysh jo vetëm çmimin e blerjes, por edhe kostot e zhvillimit të infrastrukturës.

5.13 Logjistika dhe vendi i lokacionit:

Duhet te Vlerësohet se sa me efikasitet mund të rrjedhin materialet nëpër vend, duke përfshirë ruajtjen, grumbullimin dhe shpërndarjen.

5.14 Qëndrueshmëria mjedisore:

Duhet të merren parasysh praktikat e qëndrueshme mjedisore dhe burimet e rinovueshme të energjisë kur zgjidhni një vend për të reduktuar gjurmën e karbonit të objektit.

5.15 Afërsia me fuqinë punëtore:

Duhet siguruar që ka një fuqi punëtore të disponueshme dhe të kualifikuar në afërsi të kantierit për të mbështetur operacionet tuaja të prodhimit konkret.

Duke marrë parasysh këto alternativa të arsyeshme dhe duke vlerësuar tërësisht secilën prej tyre, kompania “BETON GRUP” SH.P.K. nuk e ka pasur te vështire te merr një vendim të informuar për vendndodhjen më të përshtatshme për bazën e prodhimit të betonit. Kompania e ka parë te rëndësishme dhe ka angazhuar ekspertë të cilët kanë kryer studime gjithëpërfshirëse të fizibilitetit për të zgjedhur lokacionin që përputhet më mirë me qëllimet dhe vlerat e biznesit të kompanisë BETON GRUP.

Andaj duke i marrë parasysh të gjitha alternativat e me sipërme është përzgjedhur lokacioni i bazës së prodhimit të betonit nga kompania “BETON GRUP” sh.p.k., e cila ka qasje të mire me autostraden “Ibrahim Rugova”, ka energjinë elektrike afër po ashtu ka edhe ujera nëntokësorë në sasi të mjaftueshme e cila ka planifikuar hapjen e pusit nëntokësor.

6. GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT

Si një nga komunat më e pazhvilluara në vend, Malisheva ka një mjedis relativisht të pastër, por ajo është larg nga të qenit jo e ndotur. Kontaminimi i tokës dhe ujit, me mbetjet e ngurta dhe ujërat e zeza, guroret, degradimi i pyjeve, humbja e tokës bujqësore përmes ndërtimit të paligjshëm janë kërcënime aktuale nëpër tërë territorin e komunës. Studimet hulumtuese dhe profesionale për përcaktimin e normës së ndotjes (ujit, tokës dhe ajrit) në komunë nuk janë bërë ende. Ky problem nuk është i pranishëm vetëm në komunë, por është i pranishëm edhe në nivel vendi. Zgjidhja e këtyre çështjeve do të përmirësojë ndjeshëm gjendjen në mbrojtjen e mjedisit

Bazuar në njohuritë e përgjithshme mbi situatën në Kosovë dhe sondazheve në terren, burimet kryesore të ndotjes në komunën e Malishevës mund të konsiderohet se janë:

- Ndezja e mbetjeve të plastikës dhe gomës , Gurëthyesit, Ndezja e mbetjeve në deponi të egra, Trafiku rrugor, sidomos në afërsi të rrugëve rajonale e nacionale, me një përqendrim më të theksuar në qytetin e Malishevës, Shkarkimi i ujërave të zeza pa trajtim paraprak, Ngrohja individuale me karburante;

Gjithashtu edhe sektori i transportit është një ndër sektorët që ka ndikim mjaft negativ në gjendjen e mjedisit dhe në cilësinë e përbërësve të tij (ajrin, ujin dhe tokën). Ai po ashtu ndikon edhe në fragmentimin dhe degradimin e habitateve, ndryshimin e peizazhit, destinimin e shfrytëzimit të tokës dhe trashëgiminë kulturore. Kjo gjendje e kërcënon mjedisin duke shkaktuar ndotjen e ujit, ujërave nëntokësorë, ajrit dhe dheut dhe si pasojë shkakton dëmtim të resurseve natyror dhe humbje të tokës bujqësore.

6.1 Flora dhe Fauna

Gjendja e florës dhe faunës nuk është e kënaqshme, shkaktarë të kësaj gjendje janë: gjuetia e paligjshme dhe pa kriter, përndjekja dhe kapja e kafshëve me qëllim tregtie, shqetësimi i vazhdueshëm nga ana e njeriut, peshkimi i paligjshëm, prerja, djegia dhe dëmtimi i pyjeve, shkatërrimi i habitateve natyrore, ndikimi i urbanizmit, transportit dhe turizmit, etj. Zhvillimi veprimtarive të shumta dhe të ndryshme në natyrë, siç janë: ndërtimi i vendbanimeve, zhvillimi i turizmit malorë, prerja e pyjeve, gurthyesit etj., shpeshherë janë bërë pa një kriter të qëndrueshëm për ruajtjen e natyrës. Ky shfrytëzim i natyrës dhe i vlerave të saja ka atakuar ekosistemet dhe diversitetin biologjik në masë të konsiderueshme. Sa i përket florës, drunjtë që rriten në këtë territor janë ahu, lisi, thana dhe në rrethinat e Mirushës rriten shelgjet. Nga 32 barishtet rritet lulëkuqja (*peonia decore*), si dhe bimët mjekësore si bar-veshi, bar-pezmi, etj. Fauna në malet e Berishës karakterizohet me kafshë të egra si macja e egër, shqiponja, dallëndyshja, lejleku, bilbili, etj. Duke e pasur parasysh shtrirjen e sipërfaqeve pyjore në pjesët lindore dhe perëndimore kodrinore të territorit komunal, të pasura me një shumëllojshmëri të botës bimore dhe shtazore, si dhe korridoret përgjatë lumenjve që shtrihen përgjatë territorit komunal duke i lidhur këto tërësi pyjore, mund të thuhet se Komuna e Malishevës shquhet me një rrjet ekologjik i cili është i shpërndarë përgjatë tërë territorit të saj. Ky rrjet ofron potenciale hapësinore, mjedisore, si dhe të qarkullimit, andaj ato duhet të mbrohen dhe trajtohen në mënyrë qëndrueshme në të ardhmen.

Biodiversiteti - Në Komunën e Malishevës ekziston një larmi e bimësisë e cila gjendet edhe në Pendëkaposhi i Mayerit, Petriku i Grojterit, të cilat gjendet në zonën e Mirushës dhe është në listen e Bimëve endemike të florës vaskulare, karakteristike për Kosovën (Burimi: Flora vaskulare Endemike e Kosovës); Gipsofilë (emri shkencor *gypsophila spergulfolia* Griseb), e cila është bime e rrallë; Lule Bozhuri Bozhuri dekorativ / *Paeonia decera* Anders, të cilat gjenden në territorin e Malishevës.

Në kuadër të territorit komunal janë të listuara edhe 19 monumente të natyrës. Në kuadër të tyre përfshihen Malet e Berishës, Liqeni Artificial në Mirushë, rrjedha e lumit Mirusha, me rëndësi hidrologjike dhe peizazhore⁴; burimi në fshatin Burim, 4 shpella (Temeqinë, Ularicë, Bardh, Drenoc), 10 drunj karakteristik: trungu i Qarrit në Lladrovç, Carravanë, Drenoc, Bubël, Bellanicë⁵ trunget bungutës me karakter botanik në fshatin Llozicë, Guriq; trungu i frashrit gjethengushtë në Javiq dhe Zabeli dhe Vrella në Vërmicë. Prej këtyre monumenteve, Malet e Berishës klasifikohen në kategorinë III, për shkak të vlerave mjedisore që i ka.

6.2 Klima dhe Temperatura

Klima - e komunës së Malishevës është Klimë dominuese është ajo e mesme kontinentale dominon me elemente të ndryshme mesdhetare, e cila karakterizohet me dimër të ftohtë dhe të gjatë (në fshatrat malore); verë të ngrohtë (në fshatrat më të ulëta). Temperatura mesatare është 24.6° në verë, si dhe -10° C në dimër. Sasia mesatare e reshjeve është afër 755,5 mm³.

6.3 Karakteristikat Hidrografike

Lumi kryesor që kalon nëpër komunën e Malishevës është Mirusha, i cili i takon pellgut të Drinit të Bardhë. Mirusha buron nga malet e Bllacës (masivi malor i Carralevës), ndërsa burimi përbëhet nga dy degë (përrenj): përroi që rrjedh nga Nguncati dhe përroi që rrjedh nga Bllaca. Të dy këtë përrenj bashkohen në hyrje të fshatit Bellanicë për të krijuar lumin Mirusha (shih më poshtë Hartën e rrjetit hidrografik). Në pjesën e poshtme të lumit Mirusha, në një gjatësi 2 km, është krijuar një grykë me 16 liqene lumore të madhësive të ndryshme, të lidhura me njëri-tjetrin me një ujëvara spektakulare me gjatësi prej 21 m (i dyti nga madhësia në Kosovë pas asaj në Radavc-Drini i Bardhë). Duke pasur parasysh vlerat mjedisore që Mirusha.

përmban në rrjedhën e saj dhe hapësirat përreth, zona rreth saj është shpallur Monument Natyror me Rëndësi të Veçantë. Malisheva është e njohur edhe për burimin e ujit termal, i cili gjendet në fshatin Banjë, në anën e djathtë në lumit Mirusha. Në afërsi të këtij burimi është ndërtuar edhe pishina e hapur publike. Burime tjera të rëndësishme ujore në komunë janë: dy burime në fshatrat e Gurbardhit, burimet në fshatin Javiq dhe Panorc, rrjedha Belak në fshatin Maxharrë dhe burime të tjera ende të pa-evidentuara në malet e Gurbardhit.




Figura 8 Rrjeti Hidrografik i komunës së Malishevës

6.4 Lagështia relative e ajrit

Lagështia mesatare e ajrit gjatë vitit është 63,2%. Lagështia më e madhe mesatare e ajrit është në dhjetor, kurse më e vogla në qershor.

6.5 Vrantësimi dhe diellosja

Diellosja është e mirë, me një numër të mjaftueshëm ditësh me diell dhe 1958 orë në vit. Numri mesatar i ditëve të vrenjtura (75.9) dhe të kthjellëta (155. ditë) gjatë vitit është i volitshëm.

6.6 Të reshurat

Sasitë e të reshurave në këtë rajon janë mesatare. Mesatarja vjetore shumëvjeçare e të reshurave në pjesën kodrinore-fushore është rreth 600 mm, e në pjesën bregore-malore arrin mbi 1.025 mm. Pjesa më e madhe e këtyre reshjeve bie në dimër në formë bore, por edhe shiut.

6.7 Era

Erërat janë me shpejtësi të mesme 1.3 m/s, më të shpeshtat ato jug-perëndimore dhe perëndimore.

7. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Ndërtimi i bazës së Prodhimit të betonit mund të ketë disa ndikime mjedisore gjatë gjithë ciklit të tij jetësor, nga nxerrja-sjellja e lëndëve të para deri te asgjësimi i mbetjeve. Këto ndikime mund të ndryshojnë në varësi të faktorëve të tillë si vendndodhja e objektit të prodhimit të betonit, lloji i materialeve të përdorura dhe proceset e prodhimit.

